

Komunikatë për media

18 Korrik 2007

Agjencia Kosovare e Mirëbesimit shpall rezultatet e valës 26 të privatizimit

PRISHTINË – Agjencia Kosovare e Mirëbesimit (AKM) sot në ceremoninë e hapjes së ofertave të valës 26 të privatizimit, shpalli ofertuesit e përkohshëm fitues të Ndërmarrjeve të Reja të shitura përmes “Spin-ofit të rregullt”.

Gjithsej 14 Ndërmarrje të Reja kanë qenë në dispozicion. Te gjitha 14 Ndërmarrjet e Reja ishin në shitje përmes “Spin-ofit të rregullt”.

Ofertat u pranuan në zyrat qendrore të AKM-së në Prishtinë nga ora 10:00 deri në ora 12:00.

Ofertat janë hapur dhe rezultatet janë shpallur në selinë qendrore të UNMIK-ut, nga ora 13:00 deri në ora 14:00.

Gjithsej janë pranuar 65 oferta.

Vlera e tërësishme e ofertave më të larta ishte: 3,752,298€

Rezultatet dhe fituesit e dhënë më poshtë janë të përkohshëm. Agjencia Kosovare e Mirëbesimit tani është duke punuar që të përfundoj të gjitha shitjet, të cilat varen nga kontrollimi i historikut dhe përfundimi i pagesave nga ofertuesit e përkohshëm.

Ndërmarrjet e Reja:	Ofertuesi	Çmimi
1. Depo dhe Toka Bujqësore në Gërmovë Sh.P.K	P01	309,990€
2. Toka Bujqësore në Nec	P45	106,122€
3. Toka bujqësore në Pozharan-Stub	P31	51,500€
4. Tokë Bujqësore Beli Dub	P58	156,555€
5. Depo në Pozharan	P34	50,150€
6. Pasuria Bujqësore depo	P50	503,835€
7. Ndërtesa Administrative dhe Toka Bujqësore Rakosh	P41	321,123€
8. Toka Bujqësore Drenovc	P24	410,000€
9. Ndërtimtari	P49	721,721€
10. Llapi Shitorja Nr. 1 dhe Shitorja Nr. 2	P19	74,100€
11. Komuna Klinë – Njësia prodhuese	P43	202,202€
12. Podrima Rahovec – Shitoret në Qendër	P15	378,500€
13. Kooperimi Agro-qendra në Suharekë	P62	131,500€
14. Kosovatrans/Baza e Riparimit Teknik & Autobusët, Prizren	P28	335,000€